



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.214/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Kymete Kicaj kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Koalicija Vakati, me seli në Dragash, paraqitur kundër anëtarit të Socialdemokratska Unija (SDU) Behat Brenolli dhe kundër anëtarit të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve të komunës Dragash, Adis Idrizi, për shkak të presionit ndaj votuesve, në ditën e votimit për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 15.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZL.Anr.214/2025, e datës 14.10.2025 nga subjekti politik, Koalicija Vakati, me seli në Dragash, paraqitur kundër anëtarit të Socialdemokratska Unija (SDU), Behat Brenolli dhe kundër anëtarit të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve të komunës Dragash, Adis Idrizi, për shkak të presionit ndaj votuesve, në ditën e votimit për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025

A r s y e t i m

Me datë 14.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën ZL.Anr.214/2025 e subjektit politik Koalicija Vakati, me të cilën pretendohet se në fshatin Krushevo të Dragashit, janë vërejtur shumë shkelje, sipas tyre kryesi i listës së SDU-së, Behar Brenolli, ka asistuar votues (për dy persona në orën 11:48), gjithashtu të njëjtën gjë e ka bërë edhe anëtar i KKZ-së dhe nënpunësi i kujdesit social, Adis Idrizi i cili ka asistuar votues disa herë, duke i drejtuar si të votojnë rreth orës 13:00-15:00. Ankuesi pretendon se kur një anëtar i komisionit zgjedhor i ka tërhequr vëmendjen se nuk duhet të asistojë më shumë se një herë, Idrizi ka përgjigjur: “Unë jam anëtar i KKZ-së dhe mund të bëj ç’të dua, kjo përgjigje tregon arrogancë dhe abuzim me pozitën. Në vendvotimin 0520/01, parashtruesi i ankesës pretendon se është vërejtur edhe votim i organizuar familjar, si dhe raste kur pas paravanit (vendi ku votohet) kanë qëndruar dy ose tre persona njëkohësisht, gjë që është në kundërshtim me ligjin zgjedhor dhe rregullat për fshehtësinë e votimit. Tutje theksohet se

e gjithë kjo nuk është regjistruar në librin e evidencës nga kryetari i vendvotimit Mujidin Brenoli. Për këto parregullsi ka tërhequr vëmendjen edhe anëtar i komisionit Benjamin Tairovci, i cili ka hartuar edhe një ankesë të shkruar, të bashkangjitur në materialin e mbyllur zgjedhor .

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik Socialdemokratska Unija (SDU), thekson se ankesa e parashtruar është e paraqitur pas skadimit të afatit të parashikuar prej 48 orësh duke e bërë të papërshtatshme në kohë dhe të papranueshme për shqyrtim. Tutje, shtojnë se kryetari i këshillit të vendvotimit nuk ka evidentuar asnjë parregullsi në procesverbalin e punës së vendvotimit, e as që ndonjë anëtar i Komisionit ka raportuar incidente ose shkelje të procesit zgjedhor. Tutje kanë shtuar, menaxheri ka konfirmuar në raportin e tij se zgjedhjet në vendvotimin e përmendur kanë vazhduar plotësisht në përputhje me ligjin dhe rregullat zgjedhore, pa asnjë ankesë të regjistruar ose ndërhyrje në punën e KVV-së e as në procesverbalet e votimit, të nënshkruara nga përfaqësuesit e të gjithë subjekteve politike nuk ka vërejtje që mund të lidhen me pretendimet e ankesës. SDU theksojnë se nëse do kishte ndërhyrje në procesin e votimit, do ishte e dukshme dhe e mundur të konstatohej nga vetë procesverbalet. Sa i përket pretendimeve që Adis Idrizi ka thënë: “Unë jam anëtar i KKZ-së dhe mund të bëj ç’të dua” , nuk është thënë kurrë dhe nuk ka asnjë provë ose deklaratë nga ankuesi që mund të mbështetet dhe se Idrizi ka qënë vetëm për t’a ushtruar të drejtën e tij të votimit, pra për të votuar. Duke marrë parasysh këto rrethana, SDU kërkojnë të hedhe poshtë ankesën e Koalicionit “Vakat” si të pasafatshme dhe të pabazuar në përputhje me nenet 8,9 dhe 10 të Rregullores nr.01/2025 .

Në përgjigjen në ankesë të Komisionin Qendror të Zgjedhjeve – KQZ, theksojnë se pretendimet nga subjekti politik Koalicija “VAKAT” i cili pretendon se bartësi i listës së SDU, Behar Brenolli, ju ka asistuar votuesve (2 persona në orën 11:48) dhe nga Adis Idrizi anëtar i KKZ-së dhe nënpunësi i kujdesit social, që paraqet shkelje të ligjit të zgjedhjeve, KQZ, pas pranimi të kërkesës së PZAP, menjëherë ka kontaktuar me KKZ e komunës së Dragashit, duke pranuar përgjigjet dhe sqarimet si në vijim: KKZ në Dragash njofton se nuk kanë pranuar nga KVV-të asnjë raport, informatë, apo shprehje të pa kënaqësive eventuale në ditën e zgjedhjeve, pas ditës së zgjedhjeve dhe as në procesin e fillimit të numërimit të votave për Kryetar të komunave dhe me pretendimet e palës ankues. Më tutje ,KQZ thekson se në librin e votimit të këtij Vendvotimi përmendet vetëm emri i Adis Idrizit e jo diqka më shumë. KQZ, njofton se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe kamerat e sigurisë, momentalisht gjendet në QKN të komunës së Dragashit, mirëpo pas përfundimit të gjithë procesit të punës së QKN i njëjti material zgjedhor dorëzohet nga QKN në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve -QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet e drejtësisë.

Si prova, KQZ në përgjigje ka bashkangjitur:

1. Përgjigja e KKZ-së Dragash, lidhur me pretendimet e palës ankuese ; 2. Librat e votimit për vendvotimin Nr. 0520/01.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Nga pretendimet në ankesë lidhur me presionin ndaj votuesve të paraqitura nga subjekti politik, Koalicija Vakrat, Paneli vlerësoi se kryesuesi i listës së SDU-së, Behar Brenolli dhe anëtari i KKZ-së dhe nënpunësi i kujdesit social, Adis Idrizi, janë të paqëndrueshme sepse nuk ka ofruar asnjë provë lidhur me këto pretendime. Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës, se kanë asistuar si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 37 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.08/L-228, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme i cili përcakton "Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë: 1.1. shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga Qendrat e Votimit, dhe oborri i së njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi të votuesit", andaj Paneli e refuzoi ankesën të pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës parashtruesi i ankesës nuk i ka mbështetur me prova pretendimet e tij se kryesuesi i listës së SDU-së, Behar Brenolli dhe anëtari i KKZ-së e nënpunësi i kujdesit social, Adis Idrizi, komuna Dragash, ka bërë shkelje nga dispozita ligjore të nenit 37 par.1. dhe nënparagrafi 1.1. të LZP-së, ashtu siç pretendohet në ankesë.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nën në mënyrë decisive thuhet se "Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse", andaj vlerësoi se ankesa është e pabazuar, pasi që nga provat e ofruara të cilat parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur si dëshmi, nuk mund të vërtetohet se është kryer shkelja e pretenduar për të cilën referohet pala ankuese.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nën 117 paragrafi 3, nën 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL.Anr.214/2025 më datën 15.10.2025.

Kryesuese e Panelit
Kymete Kicaj



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykata Supreme të Kosovë, brenda 48 orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.